VENDIM
Nr. 711, datë 9.9.2020

PËR TRANSFERIMIN E PRONËSISË SË 100% TË AKSIONEVE TË SHOQËRISË "ALBAFILM" SHA, TIRANË, NGA MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË TE MINISTRIA E KULTURËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nenit 4, të ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995, "Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare", të ndryshuar; të neneve 13 e 14, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar; të nenit 9, të ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", si dhe të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin e pronësisë së 100% të aksioneve të shoqërisë "Albafilm" sh.a., Tiranë, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë te Ministria e Kulturës, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, shoqëria "Albafilm" sh.a., Tiranë, dhe Ministria e Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe